



Partia Liberale Egjiptiane – PLE

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2019 - 31 Dhjetor 2019

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informata të përgjithshme	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10 - 14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë Partise Liberale Egjiptiane

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion

Ne kemi audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik "Partija Liberale Egjiptiane" (në vijim referuar si "Subjekti Politik" apo "PLE"), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2019, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin që përfundon me këtë date, dhe informacionin tjetër shpjegues te përfshira ne fq 7-14

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2019, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Subjekti politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve te kontabilitetit te aplikueshme ne Kosove.
- Subjekti politik e ka te definuar me status limitin e pagesave me para te gatshme dhe tërheqjet nga banka, gjithsesi këto kërkesa nuk janë respektuar dhe subjekti politik ka kryer pagesa ne para te gatshme dhe tërheqje nga banka duke tejkaluar limitet e parapara me statut.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrolle të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e



Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Haxhi Nimanaj
Auditor Ligjor
6 Tetor 2021



Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2019	Me 31 Dhjetor 2018
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	0.00	
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	1,259.76	3,792.58
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		1,259.76	3,792.58
Total pasuritë		1,259.76	3,792.58
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		3,662.03	1,162.09
Suficiti / (deficiti) i vitit		(2,552.32)	2,499.94
Total Ekuiteti		1,109.71	3,662.03
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme		0.00	
Të hyrat e shtyera	5	0.00	
Gjithsej detyrimet afatgjata			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	0.00	
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	150.05	130.55
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		150.05	130.55
Gjithsej detyrimet		150.05	130.55
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		1,259.76	3,792.58

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2019	2018
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		31,500.00	31,500.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	500.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	5		
Të hyrat tjera			200.00
Gjithsej të hyrat për vitin		32,000.00	31,700.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	12,908.10	16,661.95
Shpenzimet e transportit	2	4,967.65	4,390.42
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	6,520.58	6,361.66
Shpenzimet e fushatës	2	8,298.00	
Blerja e mallrave	2	85.75	634.53
Shpenzimet e përgjithshme	2	199.15	463.60
Shpenzimet e ndryshme	2	1,573.09	687.90
Gjithsej shpenzimet për vitin		34,552.32	29,200.06
Suficiti / (deficiti) për vitin		(2,552.32)	2,499.94

1. Informata te përgjithshme

Partia Liberale Egjiptiane –PLE

Udhëheqja: Veton Berisha (Kryetaer i partisë)
Përfaqësues i autorizuar financiar – Suhat Ademi

Selia e partisë: Rr. Hekurudha nr.25 ,
Fushe Kosove

Pasqyrat financiare e PLE janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare në bankën PCB.

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	11,300.00	11,300.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	613.50	555.50	58.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	613.50	555.50	58.00
Tatimet në të ardhura personale	381.10	347.05	34.05
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	12,908.10	12,758.05	150.05
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	4,087.65	4,087.65	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	880.00	880.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	4,967.65	4,967.65	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			0.00
Ushqimi	6,520.58	6,520.58	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			0.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	6,520.58	6,520.58	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	8,298.00	8,298.00	0.00

Partia Liberale Egjiptiane

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019

Gjithsej shpenzimet e fushatës	8,298.00	8,298.00	0.00
Furnizimi i zyrës	85.75	85.75	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	85.75	85.75	0.00
Qiraja e lokalit të zyrës	100.00	100.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	99.15	99.15	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00	////////////////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	199.15	199.15	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	1,573.09	1,573.09	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	1,573.09	1,573.09	0.00
Gjithsej shpenzimet	34,552.32	34,402.27	150.05

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Sutki Abazi	Gjermani	//////////	15.10.2019	500.00		500.00
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				500.00	//////////	500.00

Numri personal i donatorit është i njohur për auditorin dhe KQZ-ën, por sipas Ligjit Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale nuk paraqitet në shënimin nr. 3 për publikun.

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					//////////

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	//////////	//////////	//////////	//////////	//////////

Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro
.....bleresi 1		
.....bleresi 2		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	0.00	0.00

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro
Paraja në bankë	838.83	1,940.49
Paraja në arkë	420.93	1,852.09
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	1,259.76	3,792.58

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro
.....furnitori 1		
.....furnitori 2		
.....furnitori 3		
.....furnitori 4		
Llogari te pagueshme te tjera	0.00	
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0.00	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	150.05	130.55
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	150.05	130.55

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguuar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Personi Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					0.00